



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



# Raporti i punës dhe aktiviteteve vjetore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

---

Janar – Dhjetor 2010

**KOMISIONI QENROR I ZGJEDHJEVE**

Prill 2011

Prishtinë, Republika e Kosovës



# Përmbajtja

<b>Përmbajtja</b> .....	<b>2</b>
<b>Shkurtesat</b> .....	<b>4</b>
<b>Hyrje</b> .....	<b>5</b>
<b>1. Aktivitetet e KQZ-së gjatë vitit 2010</b> .....	<b>6</b>
1.1 Aktivitetet kryesore të KQZ-së gjatë periudhës njëvjecare.....	6
<b>2. Organizimi dhe implementimi i Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010</b> .....	<b>8</b>
2.1 Zyra për Regjistrimin e Partive Politike (Zyra).....	8
2.1.1. Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre .....	9
2.1.2. Akreditimi i Vëzhguesve të Zgjedhjeve .....	9
2.2 Shërbimi i Votuesve .....	9
2.2.1. Projekti “Votuesit e Verbër” .....	9
2.2.2. Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta.....	10
2.2.3. Votimi jashtë Kosovës.....	10
2.2.4. Certifikimi i Listës Përfundimare të Votuesve (LPV) .....	11
2.2.5. Periudha e shërbimit të votuesve.....	11
2.2.6. Periudha e kundërshtimit dhe Konfirmimit .....	12
2.2.7. Përmbledhje në lidhje me Listën e votuesve .....	12
<b>3. Operacionet në Terren</b> .....	<b>13</b>
3.1. Emërimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV) dhe stafit teknik.....	13
3.2. Miratimi i Qendrave të Votimit dhe Qendrat Alternative .....	13
<b>4. Plani Operacional i Sigurisë për Ditën e Zgjedhjeve</b> .....	<b>14</b>
<b>5. Informimi i Votuesve</b> .....	<b>15</b>
5.1. Strategjia e Informimit Publik për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010 .....	15
5.2. Mbikqyrja e Informimit Publik .....	15
<b>6. Rekrutimi i zyrtarëve të përkohshëm të Sekretariatit të KQZ-së</b> .....	<b>16</b>
<b>7. Trajnimi i Këshillave të Vendvotimeve (KVV)</b> .....	<b>17</b>
<b>8. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)</b> .....	<b>18</b>
8.1. Miratimi i Procedurave të QNR-së .....	18
8.2. Rekrutimi i zyrtarëve të QNR-së - Trajnimi .....	18
<b>9. Shpallja dhe Certifikimi i rezultateve të Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës</b> .....	<b>19</b>
<b>2010</b> .....	<b>19</b>
9.1. Shpallja e rezultateve paraprake (preliminare) të zgjedhjeve.....	19
9.2. Shpallja e rezultateve nga QNR-ja.....	19

9.3.	Certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve .....	19
<b>10.</b>	<b>Buxheti i KQZ-së për vitin 2010 .....</b>	<b>22</b>
10.1.	Buxheti i planifikuar për Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës 2010-2011 .....	22
<b>11.</b>	<b>Bashkëpunimi i KQZ-së me institucionet tjera në vend .....</b>	<b>24</b>
<b>12.</b>	<b>Bashkëpunimi i KQZ-së me institucionet ndërkombëtare.....</b>	<b>25</b>
12.1.	Bashkëpunimi me OSBE-në .....	25
12.2.	Bashkëpunimi me IFES/Zyra në Kosovë .....	26
12.3.	Nënshkrimi i Marrëveshjes me ACEEEO.....	26
<b>13.</b>	<b>Sfidat e Procesit Zgjedhor 2010.....</b>	<b>27</b>
13.1.	Lista Votuese .....	27
13.2.	Votimi jashtë Kosovës .....	27
13.3.	Votimi me Kusht.....	28
<b>14.</b>	<b>Rinumërimi i fletëvotimeve të Zgjedhjeve 12 dhjetorit 2010 dhe procesit të rivotimit të 09 dhe 23 janarit 2011 .....</b>	<b>29</b>
14.1.	Përfundimi i rezultateve të Zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010 nga KQZ-ja .....	29
<b>15.</b>	<b>Arsyet e anulimit nga KQZ-ja të rezultateve të votimit në vendvotimet e caktuara .....</b>	<b>30</b>
<b>16.</b>	<b>Asgjësimi dhe ruajtja e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve 2010.....</b>	<b>31</b>

## **Shkurtesat**

- KQZ** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
- OSCE** - Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
- KKZ** - Komisionet Komunale të Zgjedhjeve
- KVV** - Këshillat e Vendvotimeve
- PZAP** - Paneli Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa
- SKQZ** - Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
- KE** - Kryeshef Ekzekutiv
- ZRPP** - Zyra për Regjistrim të Partive Politike
- QNR** - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
- QV** - Qendra e Votimit
- IFES** - Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore
- ACEEO** - Asociacioni i Zyrtarëve Zgjedhor Evropian
- GPZ** - Grupi Punues për Zgjedhjet
- APD** - Agjencia për Prodhim të Dokumenteve
- MIM** - Memorandum i Mirëkuptimit
- MAPL** - Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal
- MASHT** - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
- MPB** - Ministria e Punëve të Brendshme
- MEM** - Ministria e Energjisë dhe Minierave
- LV** - Lista Votuese
- LPV** - Lista Përfundimtare e Votuesëve
- VV** - Vendvotimet
- ZFK** - Zarfi i Fletëvotimit me Kusht
- FPR** - Formulari i Përputhjes së Rezultateve

## Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ("KQZ") si institucion i pavarur është përgjegjës për organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve dhe të referendumeve në Kosovë sipas kronizës ligjore në fuqi, Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme 04/L-073, dhe Ligjit për zgjedhjet lokale 04/L-072.

KQZ-ja në pajtim me autorizimet e dhëna sipas nenit 11.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka themeluar brenda SKQZ-së, Zyren për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (Zyra). Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të partive politike, certifikimin e subjekteve politike që garojnë në cilatdo zgjedhje, akreditimin e vëzhguesve për të vëzhguar zgjedhjet.

Sekretariati i KQZ-së ("SKQZ") si strukturë mbështetëse e KQZ-së, i themeluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, mbështetë profesionalisht dhe teknikisht KQZ-në në organizimin dhe implementimin e tyre si në nivelin qendror, poashtu edhe atë lokal përmes zyrtarëve komunal të zgjedhjeve (ZKZ).

KQZ-ja pas miratimit të Ligjit nr. 03/L-256 për "Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme", ka miratuar harmonizimin Rregullave Zgjedhore të KQZ-së në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet e ligjit të sipërpermendur, aktivitetin e saj kryesor e ka përqendruar në përgatitjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të shpallura nga Ushtruesi i Detyrës i Presidentit të Republikës së Kosovës (UD), për datën 12 dhjetor 2010.

## 1. Aktivitetet e KQZ-së gjatë vitit 2010

Gjatë periudhës së vitit 2010, KQZ-ja në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë, ka vijuar me implementimin e aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në funksion të përgatitjeve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010.

### 1.1 Aktivitetet kryesore të KQZ-së gjatë periudhës njëvjeçare

- **Plani i Punës 2010:** Ky plan, përcakton aktivitetet, projektet, afatet e implementimit të aktiviteteve zgjedhore, procedurat e planifikimit dhe përgjegjësitë dhe mjetet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve gjatë vitit 2010.
- **Plani Operacional i Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010:** Ky plan, parasheh të gjitha përgatitjet e nevojshme për të organizuar zgjedhjet duke përcaktuar gjithashtu të gjitha afatet kohore në përputhshmëri me ligjin dhe rregullat zgjedhore të miratuara nga KQZ-ja.
- **Organizimi dhe implementimi i Zgjedhjeve të jashtëzakonshme Lokale dhe për Kryetar të Komunave:** KQZ-ja gjatë vitit 2010, ka organizuar edhe përsëritjen e votimit të Zgjedhjeve të Raundit të II për Kryetar të Komunave Lipjan, Prizren të mbajtura me datën 31 janar 2010, si dhe në Komunën e Gjilanit, të mbajtura me datën 14 mars 2010. Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Istog, të mbajtura me datën 4 prill 2010, Zgjedhjet Lokale dhe ato për Kryetar Komune në Partesh të mbajtura me datën 20 qershor 2010, si dhe Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Rahovec të mbajtura më datën 21 nëntor 2010 (Raundi i parë (I) dhe, Raundi i dytë (II), më 19 dhejtor 2010.
- **Misionet vëzhguese dhe vizitat tjera:** KQZ-ja ka marrë pjesë në disa vizita jashtë vendit, siq janë: vizita në KQZ-në e Republikës së Shqipërisë, Takimi i punës së KQZ/SKQZ dhe OSBE lidhur me “Mësimet e nxëna” në procesin zgjedhor të vitit 2009 në Mal Zi (Budvë), Takimi i punës në Republikën e Maqedonisë (Shkup), Vizita e KQZ-së në Hungari në Parlamentin Evropian.
- **Trajnimet e KQZ/SKQZ-së:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), gjatë vitit 2010 ka marrë pjesë në trajnimin për Administrimin e Zgjedhjeve të organizuara në Londër (Britani e Madhe). Trajnimi tjetër i organizuar për KQZ/SKQZ-në, është edhe ai i “BRIDGE”, i organizuar dhe financuar nga organizata ndërkombëtare IFES.
- **Përfaqësimi i KQZ-së në Grupin Punues për Zgjedhjet:** Përbërja e GPZ: Grupi Punues është në këtë përbërje: një anëtar i PDK-së, një anëtar i LDK-së, një anëtar i AAK-së,

një anëtar i AKR-së, një anëtar i LDD-së, një anëtar që përfaqëson grupin më të madh parlamentar të serbëve, një anëtar që përfaqëson komunitetin turk/goran, një anëtar nga KQZ-ja ( Kryetarja e KQZ-së), një anëtar nga Demokracia në Veprim, një anëtar nga OJQ-të që punojnë në kanalizimin e çështjeve gjinore, dhe një anëtar nga Komisioni Parlamentar për Legjislacion.

Kryetarja e KQZ-së ka përfaqësuar institucionin e KQZ-së. GPZ ka pasur katër objektiva kryesore:

- Të hartoj ndryshimet e kornizës së zgjedhjeve
- Të ju lejojë përfaqësuesve të Subjekteve Politike, Shoqërisë Civile dhe Komuniteteve të Kosovës, t'a artikulojnë një sistem të përshtatshëm zgjedhor për Kosovën
- Të sigurojë se projektligji i ndryshuar është në përputhshmëri me standardet e njohura ndërkombëtare, ndër të tjera, me protokollet e miratuara nga anëtarët e grupit: Bashkimit Evropian dhe OSBE-së për administrimin, projektimin dhe implementimin e zgjedhjeve
- Të hartojë një draft të dakorduar për miratim, përpara shpalljes së datës së Zgjedhjeve të ardhshme për Kuvendin e Kosovës.
- **Marrëveshje Bashkëpunimi:** KQZ, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Zyrtarëve Zgjedhor të Evropës (ACEEEO) më 6 Maj 2010, qëllimi i së cilës marrëveshje është pjesëmarrja në programet dhe projekte shkëmbyese, në konsultime, si dhe në bashkëpunime dhe mbështetje teknike të organizuar nga ACEEEO në çështjet e ndërlidhura me administrimin zgjedhor.
- **Vendimet e KQZ-së:** Gjatë periudhës raportuese, KQZ-ja gjatë mbledhjeve të rregullta të mbajtura, ka aprovuar dhe nxjerrë mbi gjashtëdhjetë e pesë (65) vendime. Përmes këtyre vendimeve, KQZ-ja ka vendosur për çështjet si: Certifikimin e Subjekteve Politike, Shërbimi i Votuesve/Përpilimi i Listës së Votuesve, Trajnimi, Akreditimi i Vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar, Votimi përmes postës, Votimi i personave me nevoja të veçanta, Operacionet në Terren si dhe Deklarimi Financiar i SP-ve për fushatën parazgjedhore. Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja ka zbatuar procedurat e zëvendësimeve të këshilltarëve të Kuvendeve Komunale si dhe zëvendësimit të Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, KQZ-ja ka marrë njëqind e dy (102) vendime për zëvendësimin e këshilltarëve komunal, ndërsa në gjashtë (6) kërkesa të Presidentit të Republikës së Kosovës ka rekomanduar emrat e kandidatëve të radhës për zëvendësimin e Deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Vendimet e KQZ-së janë të publikuara në web-faqen e KQZ-së: [www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org).

## **2. Organizimi dhe implementimi i Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010**

Pas shpalljes së datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës me 12 dhjetor 2010 nga UD i Presidentit të Kosovës më 02 nëntor 2010, Sekretariati i KQZ-së në përputhshmëri me vendimet e KQZ-së, ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për sigurimin e kushteve për implementimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010.

Megjithë kohën e shkurtër që kishte në dispozicion, KQZ ka arritur që brenda afateve të përcaktuara paraprakisht, të ndërmarrë të gjitha aktivitetet e parapara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme për përgatitjen dhe organizimin e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2010.

Fillimisht, Sekretariati i KQZ-së ka draftuar një Plan Operacional me të gjitha aktivitetet e parapara për këto zgjedhje, i cili më pas është miratuar nga KQZ. Në bazë të këtij plani, Sekretariati, me një personel të përhershëm prej 70 zyrtarëve dhe rreth 600 punëtorëve në baza të përkohshme dhe të rekrutuar për aktivitete të caktuara, ka kryer aktivitetet zgjedhore si në vijim:

- **Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre**
- **Shërbimi i Votuesve**
- **Operacionet në Terren**
- **Informimi i votuesve**
- **Trajnimi i Këshillave të Vendvotimeve**
- **Qendra e Numërimit dhe Rezultateve**
- **Rekrutimi i zyrtarëve të përkohshëm në SKQZ**

**2.1. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike (Zyra)** - është përgjegjëse për mirëmbajtjen e Regjistrimit të Partive Politike, Certifikimin e të gjitha Subjekteve Politike që do të përfshihen në Fletëvotim, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me Kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe Deklaratave vjetore financiare.

Në regjistrin e Zyrës, janë të regjistruara pesëdhjet e tetë (58) parti politike.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë regjistruar katërmëdhjetë (14) parti politike, ndërsa është pezulluar një (1) parti politike për mospërbushjen e obligimeve ligjore.

Zyra gjatë periudhës raportuese, ka monitoruar njëzetë e dy (22) kuvende të partive politike, nëntë (9) prej tyre janë kuvende të rregullta zgjedhore, tetë (8) kuvende themeluese, dhe pesë (5) kuvende të jashtëzakonshme.

Zyra gjatë kësaj periudhe, ka mbajtur dy (2) forume me partitë politike dhe shoqëritë civile.



Zyra ka informuar partitë politike për datën e zgjedhjeve si dhe për afatet ligjore për aplikim për certifikim. Gjithashtu. Zyra ka përgaditur pakot për aplikim për certifikim të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, dhe ka bërë shpërndarjen e tyre.

### **2.1.1. Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me rekomandim të Zyrës ka certifikuar njëzet e nëntë (29) subjekte politike prej tyre:

- Parti politike - njëzet e katër ( 24)
- Iniciativa Qytetare - tri ( 3 )
- Koalicione - dy (2)
- Janë certifikuar gjithsej 1265 kandidatë të subjekteve politike.

Pas përfundimit të certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre KQZ ka organizuar dhe mbajtur tërheqjen e shortit për renditjen e subjekteve politike në fletvotim.

### **2.1.2. Akreditimi i Vëzhguesve të Zgjedhjeve**

Komisioni Qendror me rekomandim të Zyrës ka akredituar **32,135** vëzhgues vendor dhe ndërkombëtarë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shpallur tender për auditimin e Raporteve të Deklarimit Financiar të Fushatës për Zgjedhjet Lokale 2009. Nga kompania e përzgjedhur, janë audituar shtatëdhjetë e nëntë (79) subjekteve politike (40 parti politike, 23 iniciativa qytetare, 16 kandidat të pavarur). Auditimi, është përfunduar në fund të muajit Nëntor 2010.

## **2.2. Shërbimi i Votuesve**

Shërbimi i Votuesve funksionon në kuadër të Sekretariatit të KQZ-së. Aktiviteti kryesor i tij është informimi dhe edukimi i votuesve si dhe përpilimi i listës përfundimtare të votuesve.

### **2.2.1. Projekti “Votuesit e Verbër”**

Lidhur me projektin për Votuesit e Verbër dhe obligimin kushtetues që kësaj kategorie të shoqrisë t’ju mundësohet të votojnë personalisht dhe në mënyrë të pavarur, Njësia e Shërbimit të Votuesve dhe Shoqata e të verbërve dhe me të pamur të dobësuar e Kosovës për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës në 12 Dhjetor 2010 ka realizuar votimin përmes shabllonave në

alfabetin e BRAJ-it. Çdo Qendër e Votimit ka qenë e pajisur me nga dy shabllona për votim, një informator akustik dhe një informator në alfabetin e BRAJ-it.

### **2.2.2. Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta**

Njësia e Shërbimit të Votuesve përmes Zyrtarëve Komunal të Zgjedhjeve ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura që votuesit e ngjuar në shtëpi, votuesit në institucione dhe ata me rrethana të veçanta të mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar. Poashtu është bërë regjistrimi dhe identifikimi i votuesve nga këto tri kategori. Në të njëjtën kohë janë caktuar ekipet mobile të cilët i kanë shërbyer këtyre votuesve në ditën e zgjedhjeve në përputhje me procedurën e votimit për personat me nevoja të veçanta.

Për Votuesit e Ngjuar në Shtëpi, numri i përgjithshëm ka qenë: 2.162, për votuesit në Institucione numri i përgjithshëm i votuesve ka qenë: 5.014 dhe numri i votuesve me rrethana të veçanta ka qenë 810.

Për të tri kategoritë numri i përgjithshëm i votuesve në Operacionin e Votimit me Nevoja të Veçanta është: 7.986.

Numri i Ekipave Lëvizëse (Mobile) në të gjitha komunat që i kanë shërbyer kësaj kategorie të votuesve ka qenë gjithsej 115.

### **2.2.3. Votimi jashtë Kosovës**

Operacioni i votimit përmes postës është zhvilluar përgjatë dy fazave: Faza e regjistrimit të votuesve që jetojnë jashtë Kosovës dhe faza e dërgimit të fletëvotimeve, përkatësisht e votimit.

Regjistrimi për të votuar përmes postës është ndërmarrë në mes 5/11- 16/11/2010, ashtu siç përcaktohet me Rregullën Zgjedhore nr. 15/2010 “Zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe zgjedhjet e parakohshme”. Njësia e Shërbimit të votuesve ka dërguar 2546 formular dhe të gjitha materialet e nevojshme informuese votuesve të zgjedhjeve të kaluara në 26 shtete. Po ashtu 900 Formular për regjistrim dhe materiale informuese janë dërguar edhe tek 45 pikat shpërndarëse në 24 shtete. Informatat e nevojshme dhe formulari janë publikuar në ëeb-faqen zyrtare të KQZ-së, si dhe janë realizuar dhe transmetuar spote radiotelevizive për të nxitur dhe informuar qytetarët jashtë Kosovës për pjesëmarrje në zgjedhje.

Deri në përfundim të periudhës së regjistrimit janë pranuar 5015 aplikacione. Janë aprovuar 1640 votues, ndërsa janë refuzuar 3228. Prej tyre 147 aplikacione kanë qenë të dyfishta.

Numri i përgjithshëm i votuesve në listën e Votuesve jashtë Kosovës është: 1.640 votues.

#### **2.2.4. Certifikimi i Listës Përfundimare të Votuesve (LPV)**

##### **Qëllimi**

Në bazë të nenit 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja është e obliguar që të certifikoj listën e votuesve në raport me zgjedhjet e caktuara. Ky dokument e mbështetë procesin e certifikimit të listës së votuesve.

##### **Përmbledhje**

Lista Përfundimtare e Votuesve (LPV 2010) për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010, bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Civil. Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia për Prodhimin e Dokumenteve (APD), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

LPV-ja 2010 përmban 1, 630, 636 emra të votuesve të ndarë në 37 komuna, me një rritje prej 73,288 apo 4,4% në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Numri i Qendrave të Votimit (QV), është 746 (ashtu siç ka qenë edhe në zgjedhjet e kaluara), ndërsa numri i vendvotimeve është 2280, me një rritje prej 24 vendvotimeve apo 1.0 % nga zgjedhjet e kaluara.

Gjithashtu Lista e Votuesve jashtë Kosovës 2010 përmban të gjithë votuesit me zotësi juridike të regjistruar suksesshëm. Numri i përgjithshëm i votuesve jashtë Kosovës është 1640. Në krahasim me zgjedhjet e kaluara janë 162 votues më pakë që janë regjistruar për të votuar përmes postës.

Pas një caktimi fillestar të votuesve, kanë pasuar dy periudha të rishikimeve të Listës së Votuesve:

#### **2.2.5. Periudha e shërbimit të votuesve**

Të gjithë votuesit, kanë pasur mundësi që të kontaktojnë zyrtarët ekzekutiv komunal (nga 10 deri më 16 nëntor 2010), për t'u informuar se në cilën qendër të votimit janë caktuar ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe, 4000 votues kanë vizituar zyrat e KKZ-ve. 3200 votues kanë kërkuar ndërrimin e QV (91 kanë kërkuar direkt në zyrën e shërbimit të votuesve). Nga këto kërkesa, janë refuzuar vetëm 328 për arsye objektive.

Votuesit, vazhdimisht kanë pasur mundësi të konfirmojnë qendrën e tyre të votimit në uebfaqen e KQZ-së. Gjatë kësaj periudhe, makinën kërkuese e kanë vizituar 10.213 persona.

Bazuar në këto të dhëna, Zyra për Shërbimin e Votuesve e ka krijuar Listën e Përkohshme të Votuesve (LPV). LPV-ja ka qenë prezantimi i parë publik i listës së votuesve, e cila është përdorë për Zgjedhje për Kuvendin e Kosovës 2010.

### **2.2.6. Periudha e kundërshtimit dhe Konfirmimit**

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit (nga 22/11–26 Nëntor 2010), u ka mundësuar të gjithë votuesve që ta sfidojnë LPV-në. Pas periudhës së Kundërshtimit dhe Konfirmimit, Zyra e Shërbimit të Votuesve ka pranuar 4 vendime të gjykatës Komunale. Prej tyre, dy vendime kanë urdhëruar largimin e 3 personave të vdekur nga Lista e Votuesve, ndërsa 2 vendime kanë vërtetuar kërkesën për ndërrimin e QV. Poashtu, gjatë kësaj periudhe, Regjistri Civil ka larguar 14 persona të vdekur.

### **2.2.7. Përmbledhje në lidhje me Listën e votuesve**

- Numri i Përgjithshëm i Votuesve në LPV 2010 - **1630636**
- Votues të rinjë: **73288 ose 4.4%**
  - Votues që mbushin 18 vjet – **35735 ose 2.19%**
- Kanë ndryshuar adresën: **34521 ose 2.11%**
- Numri i personave të vdekur të largua nga Lista e Votuesve - **6165**
- Numri total i kartolinave informuese - **125461**

### **3. Operacionet në Terren**

#### **3.1. Emërimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillave të Vendvotimeve (KVV) dhe stafit teknik**

KQZ-ja me datën : 27.10.2010, 28.10.2010, 29.10.2010 si dhe me dt:01.11.2010, ka emruar Komisionet Komunale (KKZ-të) për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të 12 dhjetorit 2010 për tridhjetë e shtatë (37) komuna të Republikës së Kosovës. Në zgjedhjet e 12 dhjetorit dhe për procesin e rivotimit në katër komunat Deçan, Drenas, Skenderaj, Mitrovicë dhe nga një Qendër e Votimit në (Lipjan dhe Malishevë ), janë angazhuar gjithsej 238 anëtarë të KKZ-ve në bazë të nominimeve nga subjektet politike.

KQZ-ja me datën : 28 nëntor 2010 ka emëruar Këshillat e Vendvotimeve (KVV) për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të 12 dhjetorit 2010 për tridhjetë e shtatë (37) Komuna të Republikës së Kosovës. Në zgjedhjet e 12 dhjetorit dhe Rivotimi në katër komuna dhe nga një Qendër e Votimit në ( Lipjan dhe Malishevë ) janë angazhuar gjithsej gjithsej 19.241 anëtarë të KVV-ve. Dhe 6.447 si staf teknik në kuader të Qendrave të Votimit si psh: Menagjer të QV-ve, Kotrollues të Radhes, Zyrtar të Tavolines Ndhimese, Shofer të Kombibuseve.

#### **3.2. Miratimi i Qendrave të Votimit dhe Qendrat Alternative**

KQZ-ja ka miratuar gjithsej 746 Qendrat të Votimit dhe 2.280 Vendvotime për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të 12 dhjetorit 2010/11

Të dhëna: Gjithsej 746 QV. Në zgjedhjet lokale 2009 ka pasur 2.256 Vendvotime, kurse për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare 2010, janë miratuar gjithsej 2.280 Vendvotime.

Rritja e Vendvotimeve është bërë në proporcion me QV-të për arsye se numri i votuesve për një VV nga 750 votues me vendim të KQZ-së është rritur deri në 950 votues për një VV duke pasur parasysh se edhe numri i votuesve është rritur që nga zgjedhjet lokale 2009.

KQZ-ja me datë :01 dhjetor 2010 ka miratuar 71 Qendra Alternative të Votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010/11

## 4. Plani Operacional i Sigurisë për Ditën e Zgjedhjeve

KQZ-ja ka miratuar Planin Operacional të Sigurisë për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të 12 dhjetorit 2010 . Qëllimi i Planit është krijimi i kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike për Kuvendin e Kosovës në mbarë Kosovën në një atmosferë të qetë, pa detyrime, frikësime ose lëndime të asnjë qytetari të Republikës së Kosovës.

*Për më tepër Plani Operacional i Sigurisë parasheh:*

- Në nivelin rajonal, struktura për planifikim operativ/siguri do të menaxhohet nga KQZ-ja në bashkëpunim me Policinë e Kosovës;
- SKQZ-ja në bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës të përkrahur edhe nga EULEX dhe KFOR-i.
- Nën percjelljen e vazhdueshme të PK-së i gjithë materiali sensitiv është siguruar në çdo kohë, duke përfshirë këtu transportin e materialit sensitiv që ka hyrë në Republikën e Kosovës në pikat kufitare.
- Bashkëpunimi i ngushtë në mes SKQZ-PK-Doganat e Republikës së Kosovës, ka qënë në nivelin më të lartë të bashkëpunimit.
- Për Ditën e Zgjedhjeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka formuar Njësitë e Monitorimit, të cilat kanë qënë përgjegjëse për:
  - Mbajtjen e ndërlidhjes së ngushtë me Policinë e Kosovës;
  - Mbajtjen e kontakteve të ngushta me personelin e KKZ-ve;
  - Marrjen e të gjitha raporteve mbi incidentet që arrijnë nga Menaxherët e Qendrave të Votimit, PK-ja dhe Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve dhe të mbajtura nga Koordinatori i ZLKZ-ve në SKQZ-së të informuar rregullisht për situatën ekzistuese.
  - Monitorimin e transportimit dhe kthimit të fletëvotimeve nga Qendrat Votimit deri në depot kryesore të KKZ-ve dhe kthimin e tyre prapa në QNR.

## **5. Informimi i Votuesve**

### **5.1. Strategjia e Informimit Publik për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010**

Strategjia e Informimit Publik për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës me 12 dhjetor 2010 ka përcaktuar objektivat si në vijim:

- Dhënia e informatave për procesin zgjedhor votuesve dhe partive politike;
- Inkurajimi i pjesëmarrjes në zgjedhje;
- Informimi i votuesve mbi të drejtat e tyre për votim;
- Informimi për rendësinë e votës së tij/saj;
- Informimi për mënyrën e votimit;
- Informimi mbi vendvotimin dhe ditën (kohën) e votimit.
- Miratimi i Projektit për Qendren Mediale

### **5.2. Mbikqyrja e Informimit Publik**

Fushata e Informimit Publik është menaxhuar përmes Këshillit Mbikëqyrës të Fushatës së Informimit Publik i cili i ka raportuar drejtpërdrejt KQZ-së. Këshilli Mbikëqyrës është përbërë nga anëtarë të KQZ-së dhe menaxhmenti i Sekretariatit të KQZ-së.

## **6. Rekrutimi i zyrtarëve të përkohshëm të Sekretariatit të KQZ-së**

Për shkak të pamundësisë për të arritur afatet e përcaktuara ligjore (Ligji nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe UA 2003/01 mbi Procedurat e Rekrutimit) për rekrutimin e zyrtarëve të përkohshëm që do t'i ndihmonin SKQZ-së në përgatitjen dhe organizimin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010, Sekretariati i KQZ-së ka përdorur procedura të shkurtëra për rekrutimin e zyrtarëve të përkohshëm.

Prej tyre në Qendër (Sekretariatit e KQZ-së) janë pranuar 202 zyrtarë të përkohshëm. Në 36 Komuna të Republikës së Kosovës janë angazhuar gjithsej 238 anëtarë të Komisioneve Komunale të Zgjedhore (KKZ). Ndërsa për trajnerë të KKZ-ve janë pranuar 217.

Ndërkaq prej zyrtarëve të përkohshëm me kohë jo të plotë 490 zyrtarë në Qendren e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe 35.839 anëtarë të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 si dhe procesit të rivotimit me 09 dhe 23 janar 2011. Prosesi i pranimit të zyrtarëve të përkohshëm të sipërpermendur në SKQZ është ndarë në tri faza.



## 7. Trajnimi i Këshillave të Vendvotimeve (KVV)

Për trajnimin e anëtarëve të KVV-ve për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës janë rekrutuar gjithsej 15 trajnerë në Qendër/Sekretariatit e KQZ-së dhe 203 trajnerë në terren.

Cikli i Trajnimeve të zhvillura:

- Trajnimi i Trajnerëve të Shtabit Qendror në Sekretariat me temën: *Procedurat e votimit dhe numërimit në Vendvotim* (Agjendë 3 ditore)
- Trajnimi i 203 trajnerëve të terrenit në Vushtrri (Qendra e Trajnimeve) me temën: *Procedurat e votimit dhe numërimit në Vendvotim* (Agjendë 3 ditore)
- Trajnimi i ekipeve mobile për procedurat e VPNV-ve (Agjendë 1 ditore)
- Trajnimi i Zyrtarëve të Lartë të Komisioneve Komunale Zgjedhore me temën: *Procedurat e Pranim – dorëzimit* (Agjendë 1 ditore)
- Trajnimi i Këshillave të Vendvotimeve me temën: *Procedurat e votimit dhe numërimit në Vendvotim* (Agjendë 1 ditore)
- Trajnimi rifreskues i Kryesuesve të KVV-ve
- Trajnimi i Zyrtarëve të Lartë të Komisioneve Komunale Zgjedhore me temën: *Procedurat e Shërbimit Votues*.

Përveç këtyre trajnimeve të cilat kanë qenë të parapara me Planin e Përgjithshëm Operacional, janë zhvilluar trajnime shtesë në komunat në të cilat është përsëritur procesi i votimit për Kuvendin e Kosovës 2010.

## **8. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)**

### **8.1. Miratimi i Procedurave të QNR-së**

Procedurat e QNR-së janë udhëzimet që sigurojnë realizimin e duhur të detyrave të caktuara të personelit të Qendrës së Numërimit dhe të Rezultateve. Në udhëzime përshkruhet organizimi i përgjithshëm i QNR-së dhe rrjedha e materialit të ndjeshëm të zgjedhjeve nga pranimi e deri te arkivi, si dhe detyrat që kryhen hap pas hapi në secilën hapësirë brenda QNR-së.

Procedurat e QNR-së përfshijnë përshkrimin dhe udhëzimin gjatë punës në hapësirat e ndrsyhme gjatë rrjedhës së materialit siq janë:

- hapësira e pranimi
- hapësira e mbajtjes/kontrollimit/numërimit
- hapësira e arkivit të kutive të votimit
- hapësira e arkivit të dokumentave
- hapësira e futjes së të dhënave
- hapësira e auditimit

Në të gjitha këto hapësira përshkruhet në detaje çdo aktivitet deri në deri në përpilimin dhe tabelimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga QNR-ja për t'u shpallur në KQZ.

### **8.2. Rekrutimi i zyrtarëve të QNR-së - Trajnimi**

Rekrutimi i stafit të QNR-së është zhvilluar në 2 (dy) faza: Faza e I-rë rekrutimi i stafit menaxhues të QNR-së në përbërje prej 49 zyrtarëve dhe stafit ditor të QNR në përbërje prej rreth 650 nëpunësve të QNR-së. Rekrutimi i Trajnerëve, poashtu është zhvilluar në 2 faza, ku Faza e I-rë ka qenë për stafin menagjues kurse në Fazën e II-të është trajnuar stafi ditor, i cili fillimisht është zhvilluar për mbikqyrësat dhe më pastaj është zhvilluar sipas hapësirave përkatëse. QNR-ja ka punuar në sistemin e ndërrimeve. Fillimisht ka punuar me 3 ndërrime, respektivisht 24 orë pandërprerë për 7 (shtatë) ditë.

## **9. Shpallja dhe Certifikimi i rezultateve të Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010**

### **9.1. Shpallja e rezultateve paraprake (preliminare) të zgjedhjeve**

Në bazë të rezultateve të pranuar nga Kryesuesit e Këshillave të Vendvotimit, KQZ-ja ka shpallur rezultatet preleminare për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

### **9.2. Shpallja e rezultateve nga QNR-ja**

Në bazë të rezultateve të përpiluara nga QNR-ja, duke përfshirë fletëvotimet përmes postës, fletëvotimet e votimit me kusht, fletëvotimet e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta, përfundimit të procesit të rinumërimit të fletëvotimeve të 760 kutive të votimit si dhe pas zgjidhjes së ankesave që kanë të bëjnë me procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotime, KQZ-ja me 30 janar 2011 ka shpallur rezultatet e zgjedhjeve nga QNR-ja për Zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010.

### **9.3. Certifikimi i rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve**

Pasi kanë përfunduar të gjitha procedurat në vendvotime dhe në qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha vërejtjet që u përkasin votimit dhe numërimit në vendvotim janë vendosur nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës, KQZ-ja ka certifikuar rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me 12 dhjetor 2010, procesit të rivotimit me 09 janar 2011 në komunat: Drenas, Skenderaj, Deçan dhe në vendvotimet e caktuara në Lipjan e Malishevë si dhe rivotimit në Komunën e Mitrovicës me 23 janar 2011.




Fig.1. Numri i mandateve të Subjekteve Politike të dala nga Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010

EMRI I PARTISË	VOTAT	%	MANDATE
PDK	224,339	32.11%	34
LDK	172,552	24.69%	27
VETËVENDOSJE!	88,652	12.69%	14
AAK	77,130	11.04%	12
Koalicioni AKR-PD-PSD-PPI-PPK-PNDSH-PGJK	50,951	7.29%	8
FER	15,156	2.17%	0
LDD	14,924	2.14%	0
SLS	14,352	2.05%	8
KDTP	8,548	1.22%	3
JSL	6,004	0.86%	4
VAKAT	5,296	0.76%	2
PDAK	2,871	0.41%	1
NDS	2,478	0.35%	1
BSDAK	1,818	0.26%	1
IRDK	1,690	0.24%	1
SDA	1,602	0.23%	0
PAI	1,386	0.20%	1

KTB	1,364	0.20%	0
LEK	1,010	0.14%	0
SDSKIM	1,008	0.14%	1
S.SDS	829	0.12%	0
GIG	787	0.11%	1
CDS	771	0.11%	0
SNS	749	0.11%	0
PREBK	690	0.10%	1
SDSG	598	0.09%	0
SKMS	505	0.07%	0
SNSD	486	0.07%	0
GIKN	205	0.03%	0

Tabela 2. Rezultatet e Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010

## 10. Buxheti i KQZ-së për vitin 2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organizatë buxhetore, me kod organizativ 320 dhe me kod funksional 0170. KQZ-ja financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i organizuar ne dy programe buxhetore:

- 141 Programi i Sekretariatit te KQZ-së i cili paraqet shpenzimet operacionale
- 142 Programi i Zgjedhjeve i cili paraqet buxhetin e zgjedhjeve

Raporti i shpenzimeve për zgjedhjet parakohshme parlamentare përmban te gjitha shpenzimet e krijuara për këtë proces zgjedhor. Ky raport është përgatitur ne pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit te kontabilitetit te bazuar ne para te gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar ne mënyrë te vazhdueshme gjate tërë periudhës se realizimit te shpenzimeve..

Baze për hartimin e dokumentit kane shërbyer raportet e SIMFK, te dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimit te mallit, kontratat dhe dokumentet tjera e SKQZ-se.

Të gjitha pagesat janë bere ne sistemin e kesh-it (parave te gatshme) e jo te zotimit.

Valuta raportuese është euro (€)

Shumat raportuese janë ne njësi ne €

### 10.1. Buxheti i planifikuar per Zgjedhjet e Kuvendit te Kosoves 2010-2011

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve financohet nga Buxheti i Republikes se Kosovës.

Për vitin zgjedhor 2010 Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është ndarë buxheti në shumën prej 1,837,796 € i detajuar sipas klasifikimit buxhetor si vijon:

- Pagat dhe mëditjet 388,932€
  - Shpenzime për Mallra dhe Shërbime 1,377,424 €
  - Shpenzime komunale 46,740€
  - Shpenzime kapitale 24,700 €
- Totali: 1,837,796 €

Struktura buxhetore përbëhet prej; 21.1 % të fondeve që janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje, 74.9 % të fondeve të akorduara për shpenzime, mallra dhe shërbime, 2.5% për shpenzime komunale dhe 1.5 % për shpenzime kapitale.

Gjate vitit 2010 nga KQZ-ja jane organizuar disa pale zgjedhje si :

Me 31 janar 2010 Rivotimi ne komunat e Prizrenit dhe te Lipjanit;  
 Me 14 mars 2010 Rivotimi ne komunën e Gjilanit;  
 Me 11 prill 2010 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar komune ne Istog  
 Me 09 maj 2010 Balotazhi për kryetar komune te Istogut;  
 Me 20 qershor 2010 Zgjedhjet lokale dhe për kryetar komune ne Partesh  
 Me 18 korrik 2010 Balotazhi për kryetar komune ne Partesh;  
 Me 21 nëntor 2010 Zgjedhjet për kryetar komune ne Rahovec;  
 Me 12 dhjetor 2010 Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;  
 Me 19 dhjetor 2010 Balotazhi për kryetar komune ne Rahovec;

dhe per te cilat dhe eshte ndare buxhet shtese ne vlerë prej 8,723,127€.

Tabela nr. 1: Struktura e Buxhetit 2010

Raporti i Buxhetit	Buxheti i Aprovuar Fillestar	Buxheti i Aprovuar me Ndryshime	Buxheti i Shpenzuar	Përqindja (%)
2010				
Buxheti Total 2010	1,837,796	8,723,127	5,433,362	62,2%
Pagat dhe Mëditjet	388,932	518,882	518,882	100.0%
Mallra dhe Shërbime	1,377,424	7,997,805	4,769,131	59.6%
Shpenzime komunale	46,740	71,740	38,218	53.2%
Shpenzime Kapitale	24,700	134,700	107,130	79.5%

Mjetet e buxhetit zgjedhor të KQZ-së janë shfrytëzuar sipas zërave të shpenzimeve.

Realizimi i buxhetit të Komisionit Qendror te Zgjedhjeve për vitin 2009 paraqitet si vijon:

- a. Pagat dhe mëditjet 518,882 €
- b. Mallra dhe Shërbime 4.769,131 €
- c. Shpenzime komunale 38,218 €
- d. Shpenzime kapitale 107.130 €

Totali: 5.433,362 €

Realizimi i buxhetit për vitin 2010 kundrejt planit është bërë në masën 62,2 %, kështuqë nga 8.7 milion Euro të buxhetit të lejuarj anë realizuar vetëm 5.4 milion Euro. Mjetet e pashfrytëzuara në shumën prej 3.2 milion Euro janë kryesisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Nga e tërë kjo pasqyrë e shpenzimeve mund te përfundojmë se Shpenzimet e Zgjedhjeve për Kuvend te Kosovës ne vitin 2010 ishin 2.5€ për një votues. Nëse i krahasojmë këto shpenzime me ato te Zgjedhjeve Lokal ete vitit 2009, del se këto shpenzime ishin me te ulëta për 1.4 €.

## **11. Bashkëpunimi i KQZ-së me institucionet tjera në vend**

Në funksion të bashkëpunimit rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës me 12 dhjetor 2010, KQZ-ja ka lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë për Kthim dhe Komunitete (MKK) dhe Ministrinë e Energjisë dhe Minierave (MEM).

- MiM me MAPL-në parasheh ofrimin e kushteve të nevojshme për punën e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), duke përfshirë edhe sigurimin e zyrave brenda ndërtesave të administratës komunale;
- MiM me MASHT-in parasheh bashkë punimin reciprok përkatësisht shfrytëzimin e objekteve shkollore si Qendra të Votimeve (QV), sallave të edukatës fizike për ditën e zgjedhjeve për pranimin e materialit zgjedhor si dhe objekte shkollore për organizimin e trajnimeve të KVV-ve;
- MiM me MPB-në parasheh ofrimin e mbështetjes teknike të MPB-së në krijimin e Listës Votuese përmes të dhënave nga Regjistri Civil i Kosovës dhe në ofrimin e ndihmave tjera profesionale dhe teknike sipas kërkesave të KQZ-së;
- MiM me MEM parasheh bashkëpunimin në furnizimin e pandërprerë me energji elektrike gjatë procesit zgjedhor 2010 të Qendres së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe të gjitha Qendrave të Votimit (QV) dhe Vendvotimeve (VV) gjatë periudhës prej 10.11.2010 deri më 31.12.2010.



## **12. Bashkëpunimi i KQZ-së me institucionet ndërkombëtare**

### **12.1. Bashkëpunimi me OSBE-në**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Marrëveshjen e Mirëkuptimit të nënshkruar me 25 tetor 2010 me Departamentin e Zgjedhjeve të Misionit të OSBE-së në Kosovë (DZ-OSBE) është pajtuar që t'i ofrohet përkrahje, këshilla dhe ndihmë teknike KQZ-së dhe Sekretariatit në fushat e mëposhtme:

#### **Këshilla Zyres së KE-së, zyrtarëve të SKQZ-së dhe ZRPP-së në:**

- Funkcionalizimin e Zyrave Komunale Zgjedhore;
- Obligimet që dalin nga ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- Hartimin e Planit Operacional të Zgjedhjeve;
- Operacionet Zgjedhore në Terren;
- Aspektin Procedural të Kistës Votuese;
- Format e Komunikimit me Partitë Politike;
- Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikimin e Subjekteve Politike.

#### **Asistencë:**

- Në aspektin e bazës së të dhënave lidhur me Listën e Votuesve;
- Në ofrimin e trajnimeve për zyrtarët e SKQZ-së në fusha të ndryshme sipas kërkesave;
- Logjistikë;

#### **Këshilla për KQZ-në:**

- Rreth bashkëpunimit me Asociacionin e Zyrtrëve Zgjedhor European (ACEEEO);
- Në bashkëpunimin me KQZ-të e rajonit;
- Në identifikimin e konferencave ndërkombëtare mbi zgjedhjet (vënia e kontakteve dhe realizimi i takimeve me ACEEEO-në);
- Donacione të mundshme për KQZ-në

#### **Këshilla gjatë procesit zgjedhor:**

- Lidhur me takimet e KQZ-së;
- Përgatitjen e pikave të diskutimit për takimet e KQZ-së;
- Në arritjen e standardeve të pranuar ndërkombëtare gjatë procesit zgjedhor

## **12.2. Bashkëpunimi me IFES/Zyra në Kosovë**

KQZ-ja me 02 nëntor 2010 ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me IFES/Zyra në Kosovë. Me këtë Marrëveshje IFES/Zyra në Kosovë i ofron KQZ-së mbështetje në ngritjen e efikasitetit në zbatimin e procesit zgjedhor, ndihmë profesionale, trajnime për anëtarët e KQZ-së si dhe zyrtarët e Sekretariatit të KQZ-së në kuadër të programit të USAID-it për "Ngritje profesionale të Administratës së Zgjedhjeve në Kosovë.

Në mënyrë të veçantë bashkëpunimi/ndihma e IFES/Zyra në Kosovë sipas kësaj Marrëveshjeje përqendrohet në:

- Koordinimin dhe bashkëpunimin me KQZ-në në planifikimin e dhe zbatimin e punës së QNR-së, duke përfshirë angazhimin e këshilltarëve ndërkombëtar për të bashkëpunuar rreth menaxhimit të punëve në QNR;
- Koordinimin dhe bashkëpunimin me KQZ-në në planifikimin dhe zbatimin e fushatës së Informimit Publik të KQZ-së, duke përfshirë edhe kontraktimin e një tenderuesi që do të menaxhoj dhe zbatoj fushatën e miratuar të Informimit Publik;
- Koordinimin dhe bashkëpunimin me KQZ-në në planifikimin dhe zbatimin e trajnimeve procedurale zgjedhore për vëzhgues, trajnime për gazetarë dhe përmirësimin e efektivitetit të strategjisë dhe qasjes për media të KQZ-së;
- Të siguroj trajnime BRIDGE (Ndërtimi i kapaciteteve në demokraci, qeverisje dhe zgjedhje) për KQZ dhe SKQZ-në mbi strukturat menaxhuese zgjedhore, sistemet e regjistrimit të votuesve dhe fushatat e informimit publik
- Të ndihmojë KQZ dhe SKQZ në përpjekjet për të bërë një rishqyrtim funksional të Sekretariatit të KQZ-së për të identifikuar fushat potenciale për përmirësim dhe trajnime afatgjatë.

## **12.3. Nënshkrimi i Marrëveshjes me ACEEEO**

Me datën 06.05.2010 KQZ-ja ka nënshkruar Marrëveshjen për Anëtarësim në Asociacionin e Zyrtarëve Zgjedhorë European-ACEEEO me seli në Budapest.

Përmes kësaj marrëveshjeje KQZ-ja përfiton nga pjesëmarrja në programet dhe projektet shkëmbyese, konsultimit, bashkëpunimit dhe mbështetjes teknike të organizuar nga ACEEEO në çështjet e ndërlidhura me administrimin zgjedhor.

## **13. Sfidat e Procesit Zgjedhor 2010**

Në vijim janë paraqitur sfidat dhe vështirësitë që kanë përcjellë procesin e përgatitjeve, implementimit dhe përfundimit të procesit të Zgjedhjeve Lokale 2009.

### **13.1. Lista Votuese**

- Procesi i decentralizimit dhe krijimi i 6 komunave të reja që ka pasuar me ricaktimin e kufijve ekzistues komunal. Ky proces ka përfshirë ndarjen përkatësisht caktimin e votuesve në bazë të kufijve të komunave të reja dhe caktimin e vendvotimit sipas kritereve ligjore rreth 3 km nga vendbanimi i votuesve;
- Periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit të Listës së Votuesve (procesi gjyqësor i kundërshtimit i ndërlikuar dhe i paqartë);
- Mospërputhja e fillimit të periudhës së Shërbimit të Votuesve dhe dërgimit të kartolinave votuesve të rinj dhe votuesve që iu ka ndërruar Qendra e Votimit;
- Prania e emrave të të vdekurve në Listën e Votuesve dhe mungesa e një mekanizmi efikas ligjor për pastrimin e tyre. Vështirësi procedurale dhe teknike në zbatimin e procedurave të Regjistrimit Civil;
- Periudha e shkurtë e Shërbimit të Votuesve dhe numri i vogël i votuesve që konfirmojnë përkatësisht ndryshojnë Qendrën e tyre të Votimit.

### **13.2. Votimi jashtë Kosovës**

- Operacioni/procedurat e Votimit jashtë Kosovës të ndërlikuara dhe shumë të kushtueshme;
- Pjesëmarrje e ulët e votuesve në operacionin e votimit jashtë Kosovës;
- Proces i ndërlikuar për t'u administruar;
- Dokumentet e skaduara të identifikimit;
- Proces delikat për t'u kuptuar nga votuesit;
- Shkakton vonesa në përpunimin dhe përpilimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

### 13.3. Votimi me Kusht

- Votimi me Kusht është një proces i kushtueshëm dhe i panevojshëm (i tejkaluar) për kohën e sotme;
- Votimi me Kusht komplikon sistemin si në aspektin teknik ashtu edhe të personelit pasi kërkon menaxhim të lartë teknik dhe organizativ;
- Ndikon në rritjen e mosbesimit tek qytetarët me vonesën e rezultateve nga QNR-ja;
- Ngritë rrezikun e mashtrimeve/manipulimeve;
- Ndikon në uljen e cilësisë/saktësisë së Listës së Votuesve.

## **14. Rinumërimi i fletëvotimeve të Zgjedhjeve 12 dhjetorit 2010 dhe procesit të rivotimit të 09 dhe 23 janarit 2011**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në bazë të rekomandimeve të QNR-së ka miratuar fillimin e procesit të rinumërimit të fletëvotimeve të gjithsej 890 vendvotime dhe atë:

- 760 Vendvotime nga zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010;
- 92 Vendvotime nga zgjedhjet e përsëritura të 09 janarit 2011 dhe
- 38 Vendvotime nga zgjedhjet e përsëritura me 23 janar 2011-03-15

Arsyet e rinumërimit të vendvotimeve: mospërputhja e Formularëve të Përputhjes së Rezultateve (FPR); shuma e votave të kandidatëve ka kaluar për pesë herë shumën e votave për subjektin politik; kandidati ka marrë më shumë vota kundrejt subjektit të tij politik; kandidatët kanë fituar vota, kurse subjekti politik nuk ka fituar vota.

Në pajtim me Procedurat e Punës, QNR-ja përmes ekipeve të numërimit ka bërë rinumërimin e të gjitha këtyre fletëvotimeve dhe rezultatet e rivendosura/reale të votimeve i ka përfshirë në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

### **14.1. Përrjashtimi i rezultateve të Zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010 nga KQZ-ja**

Komisioni Qendror i zgjedhjeve duke vepruar në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 106.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Rregullën Zgjedhore nr. 06/2008 “Qendra e Numërimit dhe Rezultateve”, Rregullën Zgjedhore nr. 09/2009 “Votimi dhe Numërimi në Vendvotim”, vendimin e KQZ-së të datës 18.12.2010 për rritjen e nivelit të tolerancës në mes të numrit të përgjithshëm të fletëvotimeve të hedhura dhe regjistrimit të votuesve në një vendvotim sipas rekomandimit të QNR-së ka anuluar rezultatet e zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010 në 12 Vendvotime. Nga këto vendvotime 5 prej tyre janë anuluar pjesërisht (anulimi vetëm i Zarfeve të Fletëvotimeve me Kusht (ZFK)

#### **Vendvotimet rezultatet e të cilave janë përjashtuar nga KQZ-ja:**

06/05/01, 2610D/02D, 0907E/01D, 3020A/02D, 1514E/01D, 18/03/01  
1203B/01D, 1203B02R, 1108B/01D, 1102X/08R

2110B/02D, 0307E/01R (zgjedhjet e 09 janarit 2011)

## **15. Arsyet e anulimit nga KQZ-ja të rezultateve të votimit në vendvotimet e caktuara**

Mospërputhja në mes të numrit të përgjithshëm të fletëvotimeve të hedhura dhe regjistrit të votuesve në një vendvotim mbi nivelin e tolerancës të paraparë me vendim të KQZ-së, fletëvotimeve me kusht të paignifikuar, fletëvotimeve të votuesve me nevoja të veçanta pa zarfa të sigurisë dhe nënshkrimeve të dyfishta, përdorimi i fletëvotimeve me kusht pa listën e votuesve me kusht, llogaritja dhe përzierja e fletëvotimeve me kusht me ato të rregullta dhe mospërdorimi i zarfeve të fletëvotimeve me kusht, numri i madh i nënshkrimeve të dyfishta si dhe fletëvotime të pavulosura.

## **16. Asgjësimi dhe ruajtja e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve 2010**

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 103. 4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme KQZ-ja me 01.03.2011 ka marrë vendim për asgjësimin/shkatërrimin e materialit zgjedhor të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës me 2 dhjetor 2010. Në kuadër të këtij procesi KQZ-ja ka pranuar shkresat konfirmuese nga PZAP-i dhe Zyra e Prokurori të Shtetit lidhur me evidencën e vendotimeve materialet zgjedhore të të cilave janë apo mund të jenë objekt i hetimeve lidhur me shkeljen e rregullave dhe procedurave zgjedhore. KQZ-ja këto materiale i ka përjashtuar nga procesi i shkatërrimit dhe i ka vendosur në depon qendrore të KQZ-së.

*Sfidë: Afati i papërcaktuar për asgjësimin e materialit zgjedhor që është objekt hetimi i organeve të ndjekjes, përkatësisht mosaktimi i afatit të arsyeshëm për përfundimin e procedurave hetimore lidhur me shkeljet e procedurave zgjedhore.*

*Ky raport mund të gjendet edhe në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ([www.kqz-ks.org](http://www.kqz-ks.org))*